




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / Br.	51327/21
Nr. i fq. / Br. st.	- 1 -
Data / Datum:	21/09/21
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga takimi me qytetarë mbajtur në fshatin Samadrexhë, lidhur me dëgjetet buxhetore për vitin 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datën 29.08.2021 me fillim në ora 15:00, në Shkollën "Lumni Surdulli".
Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës, etj.

Nga banorët e atij lokaliteti ishin të pranishëm 13 pjesëmarrës. Prej tyre 12 meshkuj dhe 1 femër.

Rend Dite

1. Dëgjetet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024

Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtra lidhur me investimet e bëra gjatë këtyre viteve të udhëheqjes së tij me komunën, duke filluar me projektet infrastrukturore si shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Izet Maloku, kërkon të shikohet mundësia e ndërrimit të gypit kryesor të ujësjellësit, pasi që është gyp i vjetër, gjithashtu kërkon që uji të vjen më shpejt në fshat ngase është çështje jetike për këta banorë, po ashtu si problem e thekson kanalizimin dhe rrjetin elektrik të vjetër.
2. Muhamet Rashani kërkon rregullimin e kanalizimit në rrugën “Shyqyri Rashani”, gjithashtu kërkon që e njëjta rrugë të rregullohet me trotuar.
3. Mehdi Zabërgja kërkon që të bëhet zgjedhja e çështjes së ujit si problem kryesor, kërkesë tjetër e tij është të ketë përkrahje edhe më të madhe për klubin e hendbollit të këtij fshati.
4. Ekrem Merovci kërkon që çështja e kanalizimit të gjenë zgjedhje, po ashtu kërkon vendosjen e disa pasqyrave në disa rrugë për të evituar rrezikun në trafik, kërkesë tjetër është edhe pastrimi i lumit të fshatit
5. Zejnullah Maloku kërkon që rruga “Emin Maloku” të riparohet.
6. Sami Maloku kërkon që në një afat më të gjatë kohor rreth 4 vjeçar të shqyrtohet mundësia të lidhet me rrugë Vushtrria me Podujevën nga kjo anë, rrugë e cila është rreth 4 km gjatësi.

Në fund të këtij takimi u theksua se këto kërkesa do të shqyrtohen në ekzekutivin e komunës, Komitetin për politikë dhe financa dhe rekomandohen për miratim në kuvendin e komunës për aprovim varësisht prej prioriteteve që do të përcaktohen si dhe varësisht prej disponueshmërisë buxhetore për investime kapitale për v. 2022-2024.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

